



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE

Elbasan, më .09.2025

Procesverbal -Tipi i kontrates - Sherbim

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROÇEDURËS -“Investime në pyllizime”

LLOJI PROÇEDURËS - “Procedurë e hapur e thjeshtuar – sherbim”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi CPV: 77231600-4 - Shërbime të pyllëzimit

VLERA E FONDIT LIMIT - 8,329,530 (tetëmilion e treqind e njëzet e nëntë mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë pa t.v.sh.

Ne baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontrator Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si mëposhte:

Shtojca 9;

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda

Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit nr.08, date 23.09.2024, të miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Kriteret (a-b) janë vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 08 Datë 23.09.2024 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 9;

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të ketë paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifatat vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe kërkesave specifike të Ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga administrata tatimore për gjatë tre viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të prokuruar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, referuar nenit 42 pika 3, 43 pika 2/c dhe nenit 55 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, si dhe bazuar në Nenin 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 "Per Prokurimin Publik". Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë **jo më të vogël se 20%** e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

a) Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të shërbimeve të realizuara,

ose

b) Në rast se pervoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat, si deshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, te plotesuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenit 41, pika 3 dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 - Nëse operatori ekonomik është subjekt prodhues/tregtues i fidaneve pyjorë duhet të jetë i pajisur me Liçence Profesionale Kodi II 4 (Për prodhim ose tregëtim të farërave dhe fidaneve) leshuar nga QKL.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në VKM-ne Nr.538, datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregullave të tjera nenligjore të përbashkëta", e ndryshuar, për licencat e grupit të tretë. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kapacitetin teknik dhe profesional për realizimin e shërbimeve. Licenca e kërkuar është në përputhje me zërat e preventivit të realizimit të shërbimit dhe specifikimet teknike.

2.3.3 Operatori duhet të deklarojë se ka gjendje fidanet e kërkuar në përputhje me specifikimet teknike. Deklarata duhet të shoqërohet me:

1- Çertifikate zyrtare model 3, të aneksit 4, autorizim për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit sipas modelit 4, të aneksit 4 dhe certifikate origjine të lëshuara nga Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve (ESHFF), sipas V.K.M Nr. 523, datë 13.7.2016 “Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit të fidanëve dhe bimëve”. Kjo çertifikatë duhet të jetë e vitit 2025, e cila duhet të jetë e vlefshme për sasinë dhe llojet e fidaneve të përcaktuara nga AK në dokumentat e tenderit.

2- Çertifikatën fitosanitare të leshuar nga autoritetet shtetërore (Ministria e Bujqësisë).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në V.K.M Nr. 523, datë 13.7.2016 “Për

përcaktimin e kriterëve të tregtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit të fidanëve dhe bimëve”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë gjendje fidanet e kerkuar, ne perputhje me specifikimet teknike per realizimin e sherbimit. Certifikata fotosanitare eshte ne perputhje me kerkesat e Ak per specifikimet teknike te fidaneve pasi nepermjet kesaj certificate autoriteti verifikon llojin e fidanit, moshen dhe cilesine.

2.3.4 Nëse operatori ekonomik nuk është subjekt prodhues/tregëtues i fidanëve pyjorë duhet të paraqesë kontratë furnizimi me një subjekt prodhues/tregëtues të fidaneve pyjore i pajisur me Liçence Profesionale Kodi II 4 (Për prodhim ose tregëtim të farërave dhe fidaneve) leshuar nga QKL, në të cilën duhet të përcaktohet objekti, sasia, mosha dhe lloji i fidaneve pyjorë, si dhe të shoqërohet me certifikatat e përcaktuara në pikën 2.3.3 (Çertifikate zyrtare model 3 dhe Çertifikatën fitosanitare).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a,) dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; V.K.M Nr. 523, datë 13.7.2016 “Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit të fidanëve dhe bimëve”; si dhe në VKM-ne Nr.538, date 26.05.2009 "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregullave te tjera nenligjore te perbashketa", e ndryshuar, per licencat e grupit te trete. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë gjendje apo do të vihen në dispozicion fidanet e kerkuar nga subjekte prodhues/tregëtues të fidaneve pyjore te pajisur me Liçence Profesionale Kodi II 4 (Për prodhim ose tregëtim të farërave dhe fidaneve), duke garantuar AK që fidanet do të jenë në perputhje me specifikimet teknike per realizimin e sherbimit. Certifikata fotosanitare eshte ne perputhje me kerkesat e Ak per specifikimet teknike te fidaneve pasi nepermjet kesaj certificate autoriteti verifikon llojin e fidanit, moshen dhe cilesine.

2.3.5 Operatorët ekonomikë për arsye verifikimi nga autoriteti kontraktor duhet të deklarojnë adresën e saktë të vendndodhjes së fidaneve pyjorë, duke përfshirë dhe një koordinatë gjeografike në qendër të objektit, që kanë në dispozicion, për kryerjen e këtij pyllëzimi.

2.3.6 - Operatori Ekonomik duhet të paraqesë çertifikatën e mëposhtme :

- SSH/EN-ISO 9001-2015 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë” ose ekuivalente, e vlefshme dhe të perputhet me shërbimin objekt prokurimi.

Çertifikata e mesiperme duhet të jetë e leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi. Kriteri 2.3.5 është vendosur në përputhje me nenin 79 të LPP si dhe me Nenin 44 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Ky kriter është vendosur që AK të ketë sigurinë që operatori ekonomik që do të ofertojë të jete i pajisur me certifikatën e menaxhimit të cilësisë gjë e cila krijon bindjen dhe sigurinë të AK që ky OE do të ofertojë produkte të certifikuara të një cilësie të mirë e në përputhje me standartet ndërkombëtare të cilësisë.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë **1 (një) automjet të përshtatshëm për transport mallrash** me kapacitet mbajtës minimalisht 3.5 ton për të cilin duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtme:

- **Aktin e pronësisë së mjetit përkatës;**
ose
- **Kontratën noteriale të marrjes me qira të mjetit**, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira.

Për mjete që shënohen në regjistra publikë (qoftë në pronësi apo dhe me qira) duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik, sigurancën e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit për vetë ose të tretë për ato mjete që pajisen me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e mjeteve të mësipërme, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit.

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Në realizimin e këtij aktiviteti, përveçësë sigurimit të fuqisë punëtore e cila do të angazhohet drejtë përsëdrejti në terren për kryerjen e operacioneve të punës të planifikuara, nevojitet dhe një mjet transportues, i cili nevojitet për kryerjen e transportit të fidaneve pyjore (me buk dheu) nga fidanishtja e cila subjekti fitues ka siguruar fidanët deri në brendësi të objektit ku do të realizohet pyllëzimi, të vëglave dhe mjeteve të punës, por dhe të punëtorëve që do të angazhohen në punime direkte në terren deri në objektin e pyllëzimit.

2.3.8 - Operatori duhet të përcaktojë me anë të një deklarate nga Administratori i Shoqërisë, Drejtuesin Teknik, i cili duhet të jete i profesionit Inxhinier Pyjesh për të cilin duhet të paraqesë: Kontrate pune, "Certifikate profesionale të ekspertit", për kategorinë përkatëse, referuar V.K.M nr. 288, datë 29.04.2022 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave,

kritereve për pajisjen me çertifikatë eksperti në fushën e pyjeve dhe kullotave”, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për 3 mujin e fundit.

Argumentimi. Kriteri 2.3.8 është vendosur në bazat e pikës 4, të nenit 77 të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 41, pika 4, germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe V.K.M nr. 288, datë 29.04.2022 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave, kritereve për pajisjen me çertifikatë eksperti në fushën e pyjeve dhe kullotave”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të deklarojnë që kanë stafin teknik të nevojshëm për realizimin me sukses të shërbimit objekti të prokurimit.

2.3.9 - Një punësim mesatar prej 19 (nëntëmbëdhjetë) personave, për 3 muajt e fundit të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar shoqëruar me formularët e deklaratimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e punonjësve, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit.

Argumentimi. Kërkesa është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 4, germa c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të deklarojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin me sukses të shërbimit objekti të prokurimit e, që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen si dhe gjithashtu të kenë kualifikimet e nevojshme për realizimin e shërbimit.

Në përcaktimin e numrit mesatar të punonjësve prej 19 (nëntëmbëdhjetë) punonjës, janë analizuar:

1. Kryerja e aktivitetit të pyllëzimit.

Duke marrë në konsideratë preventivin e miratuar për kryerjen e aktivitetit të pyllëzimit, tek tabela e preventivit, zëri, **Dite pune**, për realizimin e 8,16 ha pyllëzimi me llojet pyjore të planifikuara nevojiten 1342 ditë/punë, sipas zërave të punimeve të planifikuara në preventiv.

2. Kryerja e aktivitetit të zëvendësimeve.

Duke marrë në konsideratë preventivin e miratuar për kryerjen e aktivitetit të zëvendësimeve, tek tabela e preventivit, zëri, **Dite pune**, për realizimin e 1.6 ha

zëvendësime me llojet pyjore të planifikuar nevojiten 166 dit/pune, sipas zërave të punimeve të planifikuara në preventiv.

3. Kryerja e aktivitetit të shërbimeve (prashitje).

Duke marrë në konsideratë preventivin e miratuar për kryerjen e aktivitetit të shërbimeve (prashitje) tek tabela e preventivit, zëri, **Dite pune**, për realizimin e 1 ha shërbime me prashitje nevojiten 6,7 dit/pune.

Për kryerjen e këtij shërbimi vitin e parë (3 prashitje në 8.16 ha) mbështetur në të dhënat e preventivit nevojiten: 24,6 ha x 6,7 dit/pune/ha = **165 dit/pune**.

NË TOTAL NEVOJITEN.

- Pyllëzime = 1342 dit/pune
- Zëvendësime = 166 -II-
- Shërbime = 165 -II-
- Shuma : = 1673 dit/pune**

Për kryerjen e e këtij aktiviteti në të tre komponentët (pyllëzimë, zëvendësime dhe prashitje), i cili kondicionohet dhe nga kushtet klimatike, normalisht punohet në një periudhë 5 mujore.

Bazuar në aktet ligjore në fuqi për normimin e aktivitetit të punës, një punonjës gjatë një muaji duhet të punonjë 21.75 dit/pune.

Ndërsa për periudhën 5 mujore duhen: 5 muaj x 21.75 dit/pune/mujore = 108.75 dite pune/punëtor.

Për realizimin me sukses dhe cilësi të këtij investimi në aktivitetet: Pyllëzime, Zëvendësime, shërbime nevojiten: 1673 dit/pune : 108.75 dit/pune/punëtor = **15.4 ≈ 16 punëtorë**.

Mbas riviwersimit të numurit të puntorëve, mjeteve të transportit për kryerjen e shërbimit "Investim në pyllëzime", duhen:

- 16 punonjës për kryerjen e pyllëzimeve, zëvendësimeve dhe shërbimeve kulturele.
- 1 Shofer
- 2 punonjës të stafit teknik (Administrator dhe Drejtues teknik)

TOTAL : 19 punonjës

Në vijim të rekomandimeve të dhëna nga APP-ja dhe kompleksitetit të shërbimit u analizuan zërat e preventivave (Pyllëzime, zëvendësime, shërbime kulturele), për kryerjen e shërbimit nga e cila rezultoi se numri i përcaktuar nga AK i punetoreve është i nevojshëm dhe shërben për kryerjen e këtij aktiviteti në të tre komponentët e tij.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave

të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

NJESIA E PROKURIMIT

Ardiana Merko

Oltion Kokunja

Xhulian Muça